



**MASTER I SHKENCAVE
PROGRAM I INTEGRUAR I STUDIMEVE
MJEKËSI VETERINARE**

NË BASHKËPUNIM ME BOKU & VETMEDUNI VIENNA

Pse ky program studimi?

Je i/e interesuar për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe për diagnostikimin, trajtimin e parandalimin e sëmundjeve?

Programi i integruar “Mjekësi Veterinare”, i zhvilluar në partneritet me **Universität für Bodenkultur Wien dhe Veterinärmedizinische Universität Wien**, ofron një formim 5.5-vjeçar sipas standardeve europiane.

Studimet përgatisin mjekë veterinerë të aftë të ushtrojnë profesionin në mënyrë të pavarur, duke garantuar shëndetin publik, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë ushqimore.


Programi ndërthur teorinë me praktikën dhe përgatit profesionistë të aftë për shëndetin e kafshëve, sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit publik.



Përshkrimi i programit

Programi i integruar 5.5-vjeçar (330 ECTS) është i harmonizuar me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare veterinarë, duke kombinuar formimin teorik me trajnim intensiv praktik në klinika universitare, ferma, laboratorë dhe struktura shërbimi. Përmes Labororit të Aftësive Klinike dhe metodave moderne të vlerësimit, studentët fitojnë kompetencat “Day-One” dhe diplomohen me titullin Master i Shkencave në Mjekësi Veterinare, të përgatitur për ushtrimin e menjëhershëm të profesionit dhe për akreditim ndërkombëtar.

Diplomë që njihet ndërkombëtarisht



Profili i të diplomuarit / Profil profesional

Të diplomuarit përgatiten për të punuar si:

- Mjekë veterinarë në klinika për kafshë shoqërimi dhe ferma
- Specialistë të shëndetit të tufës dhe menaxhimit riprodhues
- Mjekë veterinarë në shërbimin shtetëror dhe kontrollin veterinar
- Specialistë në Shëndetin Publik Veterinar dhe Sigurinë Ushqimore
- Inspektorë veterinarë në thertore dhe industri ushqimore
- Konsulentë në bio-siguri dhe mirëqenie të kafshëve
- Kandidatë për vazhdim studimesh në cikle më të larta, duke përfshirë doktoraturat dhe specializimet afatgjata.
- Farmacistë veterinar, Entet rregullatore të kontrollit të barnave.

Klinika e Kafshëve të Vogla



Klinika është një strukturë mësimore–klinike e dedikuar për diagnostikimin dhe trajtimin e kafshëve të shoqërimin, kryesisht qenve, maceve dhe kafshëve ekzotike. Ofron shërbime spitalore të standartizuara me ato të BE. Kombinon shërbimin veterinar me formimin praktik të studentëve, duke garantuar standarde etike dhe mirëqenie të kafshëve.

- ✓ Vizita klinike dhe konsultime të përgjithshme
- ✓ Analiza hematologjike, biokimike, hormonale, etj
- ✓ Diagnostikime dhe trajtime mjekësor të ndryshme
- ✓ Vaksinime dhe mjekime antiparazitare
- ✓ Shërbime kirurgjikale
- ✓ Shërbime diagnostike imazherike si ekografi, radiografi
- ✓ Ekzaminime të specializuara kardivaskulare
- ✓ Shërbime diagnostike dhe terapeutike në Oftalmologji

Kompetencat kryesore të fituara

Në përfundim të programit, studentët fitojnë këto kompetenca kryesore:

- Njohuri shkencore dhe ligjore veterinare, si dhe kuptim të strukturës dhe nevojave fiziologjike të kafshëve.
- Aftësi për menaxhimin, ushqimin, mirëqenien, riprodhimin dhe higjienën e tyre.
- Kompetenca klinike dhe epidemiologjike për diagnostikimin, trajtimin dhe parandalimin e sëmundjeve.
- Zbatim të programeve parandaluese, inspektime dhe njohuri mbi higjienën e produkteve me origjinë shtazore.
- Përdorim të sigurt të barnave veterinare për shëndetin e kafshëve, sigurinë ushqimore dhe mjedisin.

PËRMBAJTJA E STUDIMEVE

LËNDËT BAZË

Anatomi dhe Histologji
Fiziologji dhe Biokimi
Veterinare
Biologji dhe Biofizikë
Kimi inorganike dhe
organike
Zoologji dhe Botanikë
Veterinare

LËNDËT KARAKTERIZUESE

Patologji, Virologji dhe
Bakteriologji, Mjekësi e
Kuajve, Kafshëve të Vogla
dhe Fermës, Riprodhimi dhe
Bioteknologjia Veterinare,
Patofiziologji, Immunologji,
Toksikologji dhe
Epidemiologji, Farmakologji
,Farmakovigjilencë

TË TJERA

Laboratorë të Aftësive Klinike
(Skills Lab) me modele dhe
simulim, Praktika kirurgjikale,
Rotacione klinike në grupe të
vogla, Praktikë në ferma të
qumështit dhe blegtorisë,
Praktikë në inspektimin e
mishit, Oftalmologji

Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve laboratorike dhe klinike, aktiviteteve në klinikën universitare dhe fermat bashkëpunuese, rotacioneve klinike të strukturuar për të zhvilluar kompetencat teorike, praktike dhe profesionale të studentëve.

Mundësi Punësimi:

- Punësim në klinika veterinare private, ferma moderne blegtorale dhe industri agro-ushqimore.
- Pozicione si specialistë të shëndetit të tufës, menaxhimit riprodhues dhe shëndetit publik veterinarë
- Pozicione në laboratorë diagnostikë, programe kërkim-zhvillimi, institucione publike dhe agjenci inspektuese.
- Farmaci veterinare dhe kompani farmaceutike.
- Punësim në organizata ndërkombëtare të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, duke kontribuar në politika dhe standarde globale.

Të dhënat e programit

Niveli i studimit

Cikli i dytë – Master i Shkencave (program i integruar)

Titulli akademik

Master i Shkencave në Mjekësi Veterinare

Kohëzgjatja

5.5 vite akademike / 11 semestra

Kredite

330 ECTS

Forma e studimit

Me kohë të plotë

Gjuha e studimit

Shqip / Anglisht

Kuota studimi

60 studentë

Përfundimi i studimeve

Temë diplome (10 ECTS)



Rreth UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës u themelua më 1 nëntor 1951 dhe prej vitit 1956 është vendosur në Kodër Kamëz. Që nga krijimi, ai ka qenë një shtyllë e arsimit dhe kërkimit bujqësor në Shqipëri.

Sot, UBT luan një rol kyç në bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, përfshirë Universitetin BOKU të Vjenës.



Për më shumë informacion vizitoni:

www.ubt.edu.al

info@ubt.edu.al

Rruga "Pajsi Vodica" Tiranë

MUNDËSI VAZHDIMI STUDIMESH

Programi ofron bazën për studime të avancuara në fushën veterinarë, duke lehtësuar vazhdimin drejt doktoraturave në shkencë veterinarë dhe specializimeve afatgjata në Shëndet Publik Veterinar dhe Siguri Ushqimore, duke përgatitur të diplomuarit për role të specializuara në industri, institucione publike dhe akademi.

FOLLOW US ON SOCIAL MEDIA



Agricultural University of Tirana



[universiteti_bujqesor_tiranes](#)
[fakulteti.mjekesiseveterinare](#)



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Faqja Zyrtare
Fakulteti i Mjekesise Veterinare, UB Tirane

Për jetën dhe të ardhmen...